



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 12146 Prot.

Shkodër, më: 17.6.2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

Drejtuar:

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin për miratimin e rrjetit të linjave, stacioneve të qëndrimit dhe të tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve, në Bashkinë Shkodër.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr. _____ Prot.

Shkodër, më ____/____/2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, Datë ____/____/2025

“PËR MIRATIMIN E RRJETIT TË LINJAVE, STACIONEVE TË QENDRIMIT DHE TË TARIFËS SË BILETAVE TË TRANSPORTIT QYTETËS DHE RRETHQYTETËS TË UDHËTARËVE NË BASHKINË SHKODËR”.

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, në zbatim të nenit 23 pika 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neneve 10, 12/a, 13, 14, 15, dhe 19 paragrafi II e vijues të ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, si dhe relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër:

VENDOSI:

1. Të miratojë rrjetin e linjave dhe stacionet e qëndrimit, për transportin e rregullt të udhëtarëve në linjat qytetëse në Bashkinë Shkodër, sipas Tabelës 1 “Linjat e transportit qytetës të udhëtarëve”, dhe hartës bashkëngjitur.
2. Të miratojë rrjetin e linjave, stacionet e qëndrimit dhe numrin e orareve, për transportin e rregullt të udhëtarëve në linjat rrethqytetëse në Bashkinë Shkodër, sipas Tabelës 2 “Linjat e transportit rrethqytetës të udhëtarëve” dhe hartës bashkëngjitur.
3. Të miratojë tarifat e biletave të transportit qytetës të udhëtarëve me autobus, sipas Tabelës 3 “Tarifat e biletës të transportit qytetës”, bashkëngjitur.
4. Të miratojë tarifat e transportit rrethqytetës të udhëtarëve, sipas Tabelës 4 “Tarifat e biletave të transportit rrethqytetës të udhëtarëve”, bashkëngjitur.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

